

Termet e Referencës

Ekspert/e për hartimin e një sistemi të vlerësimit të stafit për HANDIKOS

HYRJE

HANDIKOS, “Shoqata e paraplegjikëve dhe paralizës së fëmijëve të Kosovës” është krijuar si reagim ndaj gjendjes së vështirë në të cilën gjenden personat me aftësi të kufizuara në Kosovë, e themeluar nga dhe për personat me aftësi të kufizuara, me aktivitete të pandërprera që nga viti 1983. Si organizatë përfaqëson, përkrahë dhe punon për dhe me personat me aftësi të kufizuar përmes avokimit dhe lobimit. Ofron shërbime të ndryshme përmes rrjetit të shtrirë në gjithë Kosovën dhe promovon barabarësinë, jetën e pavarur dhe me dinjitet për të gjithë personat me aftësi të kufizuara.

I. INFORMATA TË PËRGJITHSHME

HANDIKOS në partneritet me Save the Children në Kosovë është duke implementuar projektin “Handikos for Child Rights-H4CR”, i cili financohet nga Agjencia Suedeze për Bashkëpunim Ndërkombëtar dhe Zhvillim (SIDA). Përmes këtij projekti HANDIKOS synon ngritjen e kapaciteteve dhe fuqizimin e fëmijëve me Aftësi të Kufizuara.

II. OBJEKTIVA E DETYRËS

Objekti i kësaj konsulence është të angazhojë një ekspert/e për të zhvilluar një rregullore të vlerësimit të performancës së stafit dhe për të hartuar një sistem të vlerësimit të stafit për HANDIKOS.

Eksperti/ja do të jetë përgjegjës për kryerjen e një vlerësimi të nevojave për të identifikuar gjendjen aktuale të menaxhimit të performancës së stafit në HANDIKOS, që përputhet me qëllimet strategjike të organizatës, rrit performancën e punonjësve dhe mbështet rritjen profesionale.

III. KUALIFIKIMI

Kandidati duhet të posedoj këto aftësi dhe kompetenca:

- Diplomë/kualifikim në fushën e burimeve njerëzore;
- Përvojë dhe njohuri të gjerë në fusha të ngjashme;
- Aftësi për të hartuar dokumente në një format të përshtatshëm për lexuesin, duke dëshmuar shkathtësi të shkëlqyeshme analitike;
- Njohuri për praktikat më të mira në menaxhimin dhe vlerësimin e performancës së stafit;
- Njohuri të punës së organizatave joqeveritare dhe çështjet që lidhen me aftësinë e kufizuar.

IV. DETYRAT DHE PËRGJEGJËSITË

Eksperti/ja do të jetë përgjegjës për:

- Kryerjen e një vlerësimi të nevojave për të kuptuar kërkesat dhe pritshmëritë specifike për rregullimin dhe sistemin e vlerësimit të performancës së stafit;
- Zhvillimin e rregullores së performancës së stafit që përputhen me misionin dhe vizionin e HANDIKOS;
- Zhvillimin e një dokumenti të detajuar të rregullores së performancës së stafit, duke përfshirë, por pa u kufizuar në:
Kriteret dhe treguesit e performancës;
Metodat dhe mjetet e vlerësimit;
Rolet dhe përgjegjësitë e vlerësuesve dhe stafit;
Mekanizmat e feedback-ut dhe planeve për përmirësimin e performancës.

V. ANGAZHIMI I ESKPERTIT/ES

Eksperti/ja do të angazhohet me anë të një kontrate për shërbim me HANDIKOS.

Ai/ajo do të angazhohet për 6 ditë në periudhën kohore prej 3 javë dhe pritet të dorëzojë: Një dokument që mbulon përgjegjësitë e përmendura në seksionin "Detyrat dhe Përgjegjësitë".

Detyra	Kohëzgjatja
Angazhimi mbi zhvillimin e vlerësimit të performancës së stafit dhe hartimin e një sistemi të vlerësimit të stafit për HANDIKOS	5 ditë
Prezantimi i rregullores tek stafi i HANDIKOS	1 ditë
Totali i ditëve	6 ditë

VI. KUSHTET E PAGESËS

Pagesa e ekspertit/es do të bëhet sipas ofertës përkatëse për kryerjen e shërbimeve, që do të lëshohet nga ai/ajo, pas finalizimit të dokumentit/raportit.

HANDIKOS do të realizoj pagesën në Euro, shuma bruto për ditët e punës (nga të cilat do të ndalet tatimi në fitim dhe kontributi pensional sipas ligjeve në fuqi në Kosovë).

HANDIKOS rezervon të drejtën e neqocimit të propozimit financiar.

VII. PROCEDURA PËR APLIKIM

- Metodologji e punës për këtë angazhim ose shembuj të angazhimeve të mëparshme të natyrës së ngjashme;
- Curriculum Vitae (CV) (max.3 faqe);
- Propozimi financiar.

Aplikacionet duhet të dorëzohen në formë elektronike në e-mail adresën: handikos@handi-kos.org
cc: nora.simitciu@handi-kos.org

Ju lutem, shkruani në subjekt Aplikimi për: Ekspert/e për hartimin e një sistemi të vlerësimit të stafit për HANDIKOS

Afati i fundit për dorëzimin e aplikacionit është 01/10/2024, ora 17:00.

Vetëm kandidatët e suksesshëm do të kontaktohen!

Pas përzgjedhjes Eksperti/ja i/e përzgjedhur duhet të dërgojë:

- **Dokumentin/ Dëshminë që nuk është nën hetime.**

Poashtu, ai/ajo duhet të nënshkruajë edhe:

- **Rregulloren mbi Parandalimin e Shfrytëzimit dhe Abuzimit Seksual - PShAS**